

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kompaktor skarrabel dhe konteniere skarrabel”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 42415200-0,

VLERA E FONDIT LIMIT: : 6.937.428 (gjashte milion e nentëqind e tridhjetë e shtatë mijë e katerqind e njëzet e tete) Lekë pa tvsh,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kerkesat e mesiperme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, si një mjet garancie për Autoritetin Kontraktor në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë elektronikisht Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

2.1.2. Operatori ekonomik duhet të ketë të regjistruar në veprimtarinë e tij në QKB objektin për Shitblerjen e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të perdora.

Referuar Ligjit nr. 9573 date 03.07.2006, ndryshuar me Ligjin nr. 106/2018 date 20.12.2018, neni 29 pika 1. Ushtrimi i veprimtarisë së shitblerjes, të ndërmjetësimit, të autoriparimit për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të autorizuar nga prodhuesi i tyre, kryhet nga subjektet juridike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të cilat kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e këtyre veprimtarive.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP, pika 1 a dhe 2. neni 40, pika 5, të VKM nr. 285 i perditesuar, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe neni 82 pika 1 të LPP.

Referuar Ligjit nr. 9573 date 03.07.2006, ndryshuar me Ligjin nr. 106/2018 date 20.12.2018, neni 29 pika 1.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e vlerës është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 2 germa c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate *(apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 pika 4 gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 55, pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet /furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- 2.4.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për produktet e ofruara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar. Në rast se një autorizim paraqitet nga distributori i autorizuar, lidhja, bashkëpunimi i kontratës / furnizimit, ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit duhet të jetë e paraqitur me dokumentacionin përkatës.
- 2.4.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën SSH/EN/ ISO 9001: 2015 në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme.
- 2.4.3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të dorezojë mjetet prane ambjenteve të Selisë Operative të Eco Tirana Sh.a. ish parku i autobusave Rruga Don Bosko Tiranë sipas grafikut të lëvrimit të mallit dhe se ofron 24 muaj garanci për mjetet e reja objekt prokurimi.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Autoriteti Kontraktor duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të tij në fushën e veprimtarisë së tij dhe kryerjes së shërbimit ku ushtron aktivitetin në bazë të kontratës së shërbimit të administrimit të mbetjeve urbane.

ARTIKULLI/ ARTICOLO	PERSHKRIMET/SPERCIKIMET TEKNIKE DESCRIZIONE /SPECIFICHE TECNICHE	NJESI MATESE/ UNITA' DI MISURA	SASIA/ QUANTITA'
Kompaktor i lëvizshëm Monopala	Kompaktor i lëvizshëm Monopala Kontenierët do të përdoren me një pajisje të lëvizshme me gjatësi 6200 mm dhe për rrjedhojë duhet të jenë të pajtueshëm me të. - Gjatësia (pa përfshirë kordonin e pasmë): 6200 mm - Kapaciteti: 22/24 m³ - Sistemi i kompresimit: monopala - Trupi i përbërë nga 6 fletë çeliku S355JR ose ekuivalente, trashësi 4 mm (2 dysheme, 2 anësore, 2 tavan) - Fletët e salduara në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar një mbyllje hermetike - Anësoret, tavani dhe dyshemeja me profile të rrumbullakosura për një rezistencë më të madhe strukturore - Gjerësia e jashtme: 2550 mm - Lartësia nga poshtë trarëve: 2680 mm - Dyshemeja e dhomës së kompresimit e harkuar nga çelik HARDOX 450, trashësi 4 mm - Rubinet shkarkimi 2" i vendosur në pjesën e poshtme të kasës - Lartësia e dhomës së kompresimit: 920 mm - Thellësia e futjes së pales: të paktën 577 mm - Kapaciteti i lëvizjes së pales: të paktën 2.8 m³ për cikël - Fuqia shtytëse maksimale: të paktën 40 ton - Mbrojtëse cilindrash me sensorë sigurie me kanal të dyfishtë të integruar - Mbështetëse në Ertalon PA6 ose ekuivalente - Udhëzues tehes të ekstruduara tip "Hoesch" ose ekuivalente për të reduktuar konsumimin dhe për të garantuar jetëgjatësi - Kokë tërheqjeje e përparme Ø 55 mm e palosshme me kompensator, nga çelik S355JR ose ekuivalent - Kokë tërheqjeje e pasme fikse Ø 55 mm, nga çelik S355JR ose ekuivalent - Rrotulla lëvizëse Ø 168 mm, gjatësi 250 mm, përpara dhe pas, të çmontueshme - Paneli elektrik me ekran LCD, invertues automatik të fazës, sinjalizim akustik dhe dritor për komandat e përparme - Fuqia e instaluar: motor 16 kW - Raporti minimal i kompresimit: 4:1 Trampolina - E ndërtuar me fletë çeliku S355JR ose ekuivalente, trashësi 4 mm - Përmasat: - Gjerësia: 2100 mm - Gjatësia: 1800 mm - Vëllimi: të paktën 6 m³ - Mbrojtje e përparme me devijues të palëvizshëm me lartësi 1400 mm nga toka, sipas normës S.SH UNI EN 13857 - Hapje e portës së pasme pa fërkim me guarnicionin - Mbyllje hermetike me guarnicion në tre anë (fund + mbajtëse anësore) - Guarnicioni i mbajtur nga udhëzues në formë "L", i lehtë për t'u zëvendësuar - Mekanizëm mbylljeje me 4 kapëse (2 për	Cope	2

	anë), të aktivizuara nga cilindrat • Këndi i hapjes së portës: 121° • Lartësia e portës së hapur plotësisht: 4203 mm • Lartësia e kokës së tërheqjes: 1480 mm • Kokë Ø 55 mm e palosshme dhe e ndihmuar me cilindër me gaz për të reduktuar përpjekjen e operatorit Sistemi i sigurisë dhe kontrollit • Sensor për radhitjen e fazave për të siguruar drejtimin e duhur të motorit pa ndërhyrje manuale • Konfigurimi i sistemit elektrik në përputhje me S.SH UNI EN ISO 13849-1: 2008, nivelet e sigurisë PLr C dhe PLr D • Sensorë sigurie me kanal të dyfishtë me magnetë të koduar • Njësi PLC me dy procesorë dhe logjikë të dyfishtë • Kontaktor i dyfishtë në linjën e fuqisë për furnizimin e motorit Lyerja • Larje, pastrim dhe lyerje e jashtme me smalt poliuretanik me bazë uji, i katalizuar, me trashësi 70- 90 mikron • Ngjyra e vetme: RAL BARDHË		
Kontenierë të lëvizshëm me kapacitet rreth 11 m ³	Kontenierë të lëvizshëm me kapacitet rreth 11 m³ • Të përshtatshëm për pajisje të lëvizshme me gjatësi 6200 mm • Kapaciteti: rreth 11 m³ • Gjatësia maksimale: 6200 mm • Gjerësia: 2500 mm • Lartësia anësore nga toka: 1000 mm • Lartësia e brendshme e përdorshme: 750 mm • Lartësia e mbajtëseve të përparme dhe të pasme në tokë: rreth 1600 mm • Mbështetje trekëndore në lidhjen e anësoreve me pjesët e përparme dhe të pasme • Dyshe me prej çeliku FE 360 me trashësi 4 mm (40/10) • Muret anësore prej çeliku FE 360 me trashësi 3 mm (30/10) • Hapje e pasme me dyer që hapen anash dhe mundësi hapjeje me mbajtëse anësore • Guarnicion hermetik në derën e pasme • Leva e sigurisë e pozicionuar nën koshin e mbeturinave për të qëndruar brenda përmasave të containerit • Unaza në perimetrimin e koshit për të fiksuar mbulesën elastike Lyerja • Lyerje e jashtme: - o Një shtresë primeri me trashësi 30 mikron - o Dy shtresa boje epokside me trashësi totale 70-90 mikron - o Ngjyra: RAL BARDHË sipas specifikimeve tona • Lyerje e brendshme: - o Një shtresë primeri me trashësi 30 mikron - o Ngjyra: RAL BARDHË sipas specifikimeve tona	Cope	4